

MARRËVESHJE SHUMËPALËSHE/RAJONALE

1. Karta e BSEC-ut, nënshkruar më 5.6.1998, hyrë në fuqi më 1.5.1999.
2. Marrëveshje për bashkëpunimin në luftën kundër krimit me vendet e BSEC, në veçanti kundër krimit të organizuar, nënshkruar më 2.10.1998, ratifikuar me ligjin nr.8512, datë 15.7.1999, hyrë në fuqi më 23.7.2008.
3. Protokoll shtesë për luftën kundër terrorizmit të marrëveshjes ndërmjet Qeverive të shteteve pjesëmarrëse të bashkëpunimit të Detit të Zi, në luftën kundër krimit, në veçanti kundër krimit të organizuar, nënshkruar më 3.12.2004, hyrë në fuqi më 23.6.2006.
4. Protokoll shtesë i Marrëveshjes për bashkëpunimin në luftën kundër krimit, në veçanti kundër krimit të organizuar, nënshkruar më 15.3.2002, hyrë në fuqi më 26.11.2003.
5. Memorandum mirëkuptimi për zhvillimin e bashkërenduar të autostradës Unazë në Detin e Zi, nënshkruar më 19.4.2007.
6. Memorandum mirëkuptimi në zhvillimin e autostradave të deteve, nënshkruar më 19.4.2007, hyrë në fuqi më 1.5.2007.
7. Memorandum mirëkuptimi për lehtësimin e transportit rrugor të mallrave në rajonin e BSEC-ut, nënshkruar më 6.3.2002, hyrë në fuqi më 20.7.2006.
8. Protokoll mbi imunitetet dhe privilegjet e Asamblesë Parlamentare të Bashkëpunimit Ekonomik të Detit të Zi, nënshkruar më 31.10.2003, hyrë në fuqi më 1.3.2010.
9. Protokoll shtesë mbi privilegjet dhe imunitetet e BSEC-ut, nënshkruar më 30.4.1999.
10. Marrëveshje për thjeshtëzimin e procedurave të vizave për afaristët e vendeve anëtare të BSEC-ut, nënshkruar më 23.10.2008, hyrë në fuqi më 5.3.2010.
11. Marrëveshje për thjeshtëzimin e procedurave të vizave për shoferët profesionistë të kamionëve të transportit ndërkombëtar të mallrave të vendeve anëtarë të BSEC-ut, nënshkruar më 23.10.2008, hyrë në fuqi më 5.3.2010.
12. Marrëveshje ndërmjet vendeve të Organizatës së Bashkëpunimit Ekonomik të Detit të Zi (BEDZ) për bashkëpunimin në ndihmën dhe përgjigjen ndaj emergjencave dhe fatkeqësive natyrore ose të shkaktuara nga njeriu, bërë në Sochi, më 15.4.1998, hyrë në fuqi më 3.5.2011.
13. Protokoll shtesë i marrëveshjes ndërmjet vendeve të Organizatës së Bashkëpunimit Ekonomik të Detit të Zi (BEDZ) për bashkëpunimin në ndihmën dhe përgjigjen ndaj emergjencave dhe fatkeqësive natyrore ose të shkaktuara nga njeriu, bërë në 20.10.2005, hyrë në fuqi më 25.6.2011.
14. Ndryshime të neneve të marrëveshjes së themelimit të Bankës së BEDZ, aderuar me ligjin nr.7963, datë 27.2.2013, hyrë në fuqi më 21.6.2013.
15. Memorandum Mirëkuptimi për kuadrin Institucional të Iniciativës për Gatishmërinë dhe Parandalimin e Katastrofave për Evropën Juglindore (DPPI-SEE), nënshkruar në Sarajevë, më 28.11.2013, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, Qeverisë së Republikës së Bullgarisë, Qeverisë së Republikës së Kroacisë, Qeverisë së Malit të Zi, Qeverisë së Republikës së Sllovenisë, Qeverisë së Republikës së Turqisë, Qeverisë së Republikës së Serbisë, Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, dhe për palën boshnjake, më 18.4.2014.
16. Marrëveshje për shmangien e taksimit të dyfishtë ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Këshillit të Ministrave të Serbisë e Malit të Zi, nënshkruar në Tiranë, më 22.12.2004.
17. Marrëveshje shumëpalëshe e transportit për vendet e Evropës Juglindore, nënshkruar më 26.9.1998, hyrë në fuqi më 29.11.2009.

18. Traktati për kartën e Energjisë dhe protokoli, bërë më 17.12.1998, instrumenti i dorëzimit të Shqipërisë më 12.2.1998, hyrë në fuqi më 13.5.1998.
19. Marrëveshje për krijimin e Qendrës Rajonale Ballkanike për nxitjen e tregtisë, nënshkruar më 13.10.1998, miratuar me VKM-në nr.138, datë 25.3.1999.
20. Marrëveshje për krijimin e forcës shumëkombëshe të Evropës Juglindore, nënshkruar në Shkup, më 26.9.1998, ratifikuar me ligjin nr.8544, datë 4.11.1999.
21. Protokoll shtesë për krijimin e forcës shumëkombëshe të Evropës Juglindore, nënshkruar më 26.9.1998, ratifikuar me ligjin nr.8544, datë 4.11.1999.
22. Protokoli i dytë për krijimin e forcës shumëkombëshe paqeruajtëse të Evropës Juglindore (MPFSEE), nënshkruar më 31.11.2000.
23. Protokoli i tretë për krijimin e forcës shumëkombëshe paqeruajtëse të Evropës Juglindore (MPFSEE), nënshkruar më 26.6.2001, hyrë në fuqi më 15.10.2001.
24. Marrëveshja e SECI-t mbi bashkëpunimin për parandalimin dhe luftën kundër krimit ndërkufitar, nënshkruar më 26.5.1999, ratifikuar me ligjin nr.8541, datë 21.10.1999.
25. Memorandum mirëkuptimi për krijimin e lehtësirave për transportin ndërkombëtar rrugor të mallrave në rajonin e SECI-t, nënshkruar më 28.4.1999, ratifikuar me ligjin nr.8540, datë 21.10.1999.
26. Protokoll bashkëpunimi në fushën e navigimit ajror në rajonin e Ballkanit, nënshkruar më 17.11.1999, hyrë në fuqi datën e nënshkrimit.
27. Memorandum mirëkuptimi për zhvillimin e rrjetit të transportit Rajonal të Evropës Juglindore, nënshkruar më 11.6.2004.
28. Marrëveshje shumëpalëshe ndërmjet Republikës së Shqipërisë, Bosnjës dhe Hercegovinës, Republikës së Bullgarisë, Komunitetit Evropian, Republikës së Islandës, ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë, Mbretërisë së Norvegjisë, Serbi-Mali i Zi, Rumanisë dhe Misionit Administrativ të Përkohshëm të Kombeve të bashkuara në Kosovë, për krijimin e një zone të përbashkët të Aviacionit Evropian (ECAA), nënshkruar më 9.6.2006, zbatohet përkohësisht nga datat e nënshkrimit.
29. Shtesë e Memorandumit të Mirëkuptimit mbi zhvillimin e rrjetit Qendror të Transportit Rajonal në Evropën Juglindore, nënshkruar më 4.12.2007.
30. Memorandum mirëkuptimi për krijimin e forumit dhe qendrës rajonale të migrimit, azilit dhe kthimit të refugjatëve, nënshkruar më 2.7.2004, hyrë në fuqi datën e nënshkrimit.
31. Konventë për bashkëpunimin policor në Evropën Juglindore, nënshkruar më 5.5.2006, hyrë në fuqi më 10.10.2007.
32. Memorandum mirëkuptimi për bashkëpunimin e luftës kundër korrupsionit nëpërmjet nismës antikorrupsion të Evropës Juglindore, nënshkruar më 13.4.2007.
33. Konventë trepalëshe ndërmjet Republikës së Shqipërisë, Republikës së Bullgarisë dhe Republikës së Maqedonisë, për sistemin e naftës-jellësit transballkanik, nënshkruar më 31.1.2007.
34. Protokoll Karte mbi Marrëdhënie të mira fqinjësie, stabiliteti, sigurie dhe bashkëpunimi në Evropën Juglindore midis vendeve të SEECP, nënshkruar më 11.5.2007.
35. Memorandum mirëkuptimi për iniciativën e vendeve të Evropës Juglindore për parapërgatitjen dhe parandalimin e fatkeqësive (DPPISEE), nënshkruar më 24.9.2007, hyrë në fuqi më 1.1.2010.
36. Shtesë e Memorandumit të Mirëkuptimit mbi zhvillimin e Rrjetit Qendror të Transportit Rajonal në Evropën Juglindore, nënshkruar më 4.12.2007.
37. Marrëveshje për Themelimin e Shkollës Rajonale të Administratës Publike (ReSPA), nënshkruar më 21.11.2008.

38. Memorandum për garancitë ligjore dhe juridike kundër procedimit të paligjshëm të të dhënave personale ndërmjet vendeve të Evropës Juglindore, nënshkruar në Kishinjev, më 31.10.2008.
39. Marrëveshje për krijimin e një rrjeti hekurudhor të performancës së lartë në Evropën Juglindore, nënshkruar më 4.5.2006, hyrë në fuqi më 6.3.2009.
40. Traktat për krijimin e Komunitetit të Energjisë, nënshkruar më 25.10.2005, ratifikuar me ligjin nr.9501, datë 3.4.2006.
41. Marrëveshje ndërmjet Austrisë, Bullgarisë, Çekisë, Hungarisë, Polonisë, Rumanisë, Sllovakisë, Sllovenisë, për mbështetjen e bashkëpunimit bë fushën e arsimit të lartë në kuadrin e Shkëmbimeve të Studimeve Universitare në Evropën Qendrore (CEPUS II), hyrë në fuqi për Shqipërinë më 10.5.2006.
42. Konventa e qendrës për zbatimin e ligjit në Evropën Juglindore (SELEC), nënshkruar më 9.12.2009, hyrë në fuqi më 7.10.2011.
43. Protokoll i privilegjeve dhe imuniteteve të Qendrës për Zbatimin e Ligjit në Evropën Juglindore (SELEC), nënshkruar më 24.11.2010.
44. Anëtarësimi i Republikës së Shqipërisë në fondin e sigurimeve rajonale ndaj fatkeqësive natyrore, për vendet e Evropës Juglindore dhe Qendrore "Europa Reinsurance Limited" (SECE CRIF), nënshkruar më 30.10.2009.
45. Protokoll i Zagrebit për bashkëpunimin për vendet e Evropës Juglindore për bashkëpunimin për turizmin, nënshkruar më 5.4.2008.
46. Marrëveshje për konservimin e cetaceve në detin e Zi, detin Mesdhe dhe zonës vazhduese të atlantikut, nënshkruar më 24.11.1996, hyrë në fuqi më 1.10.2001.
47. Marrëveshje për RACVIAC-Qendra për bashkëpunim për sigurinë, bërë në Budva, Mali i Zi, më 14.04.2010, hyrë në fuqi për Republikën e Shqipërisë, Republikën e Kroacisë, Republikën e Maqedonisë, Malit të Zi dhe Republikën e Serbisë më 1.12.2011, për Rumaninë hyn në fuqi më 1.8.2013.
48. Marrëveshje ndërmjet Shteteve të Evropës Juglindore për qendrën e Sekretariatit të rrjetit shëndetësor të Evropës Juglindore, nënshkruar më 9.11.2010.
49. Memorandum mirëkuptimi për bashkëpunimin policor dhe mbështetjen për Sekretariatit të Konventës së bashkëpunimit Policor të Evropës Juglindore, nënshkruar më 19.10.2010, miratuar me VKM-në nr.43, datë 19.1.2011.
50. Memorandum mirëkuptimi për krijimin e Forumit Rajonal të Nismës së Migrimit, Azilit dhe Kthimit të Refugjatëve, nënshkruar më 2.7.2004, miratuar me VKM-në nr.873, datë 22.12.2004.
51. Memorandum mirëkuptimi ndërmjet Republikës së Shqipërisë, Republikës së Kosovës, Malit të Zi, Republikës së Maqedonisë dhe Republikës së Greqisë për menaxhimin e zgjeruar ndërkufitar të Basenit të Drinit, nënshkruar në Tiranë, më 25.11.2011.
52. Marrëveshje për komitetin e koordinimit në kuadër të procesit të Ministerialit të Evropës Juglindore (SEDMC), nënshkruar në Sofje, më 21.10.2009.
53. Konventa rajonale pan-Euro-Mesdhetare mbi rregullat preferenciale të origjinës, bërë në Bruksel më 15.6.2011, hyrë në fuqi më 1.5.2012.
54. Tabela e rotacionit të posteve kryesore dhe të vendqëndrimit të Komandës së Brigadës së SEEBRIG-ut, për periudhën 2015-2035, nënshkruar në Podgoricë, më 16.10.2014, hyrë në fuqi më 15.2.2016.
55. Marrëveshje shumëpalëshe ndërmjet vendeve të Evropës Juglindore për zbatimin e Konventës për vlerësimin e ndikimit mjedisor në kontekst ndërkufitar (ESPOO), aderuar nga Republika e Shqipërisë me ligjin nr.11/2015, datë 19.2.2015, hyrë në fuqi më 25.4.2015.

56. Marrëveshje për programin e shkëmbimit të studimeve universitare në Evropën Qendrore (CEEPUS III), bërë në Budva, më 25.3.2010, nënshkruar nga Shqipëria në Vjenë, më 29.7.2015, hyrë në fuqi më 1.7.2016.
57. Marrëveshje mbi Qendrën e Ballkanit Perëndimor për kërkim shkencor dhe inovacion (WISE), nënshkruar në Split më 18.9.2015 dhe në Zagreb më 21.9.2015.
58. Marrëveshje ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, Këshillit të Ministrave të Bosnjës dhe Hercegovinës, Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, Qeverisë së Malit të Zi, Qeverisë së Republikës së Serbisë dhe Qeverisë së Republikës së Sllovenisë, për ngritjen e Task-Forcës Mjekësore të Ballkanit, nënshkruar nga pala shqiptare në Tiranë, më 17.4.2015, dhe hyrë në fuqi më 4.5.2018.
59. Marrëveshje për themelimin e Fondit të Ballkanit Perëndimor dhe Statuti i saj, bërë në Pragë, më 13.11.2015, hyrë në fuqi më 25.5.2017.
60. Marrëveshje mbi Selinë e Zyrës Rajonale të Bashkëpunimit Rinor dhe Statuti i saj, bërë në Paris, më 4.7.2016, hyrë në fuqi më 26.7.2017.
61. Marrëveshje shumëpalëshe e Autoritetit Kompetent mbi shkëmbimin Automatik të informacionit të Llogarisë Financiare, nënshkruar më 29.10.2014, hyrë në fuqi në mars 2016.
62. Protokoll që ndryshon "Memorandumin e mirëkuptimit për bashkëpunimin e luftës kundër korrupsionit nëpërmjet nismës antikorrupsion të Evropës Juglindore, nënshkruar më 13.4.2007", nënshkruar më 11.7.2013.
63. Marrëveshje për ngritjen e Qendrës së Ekselencës në Financë (CEF), aderuar më 30.5.2016, hyrë në fuqi 4.7.2016 (Kroaci: 7.6.2023).
64. Protokoll mbi përdorimin e interpretimit të përbashkët në fushën e emigracionit dhe Azilit ndërmjet Qendrës Rajonale për Emigrimin, Azilin dhe Refugjatët (MARRI) dhe Shteteve palë në të, nënshkruar më 8.2.2018 dhe hyrë në fuqi në datën e nënshkrimit.
65. Marrëveshje me Vendin Pritës ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Fondit të Ballkanit Perëndimor, nënshkruar më 19.4.2018.
66. Marrëveshje trepalëshe ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, Qeverisë së Republikës së Italisë dhe Qeverisë së Republikës Greke për bashkëpunimin për projektin e Gazsjellësit Trans Adriatik (TAP), nënshkruar më 27.9.2012, hyrë në fuqi datën e nënshkrimit.
67. Marrëveshje e Përkohshme ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe kompanisë Trans Adriatic Pipeline AG (TAP AG), në lidhje me projektin e Gazsjellësit Trans Adriatik (projekti TAP), nënshkruar në Tiranë, më 18.1.2013.
68. Marrëveshje ndërmjet Republikës së Shqipërisë, Republikës Greke dhe Republikës së Italisë, për projektin Trans Adriatic Pipeline (TAP), nënshkruar në Athinë, më 13.2.2013, hyrë në fuqi më 19.2.2014.
69. Marrëveshje ndryshimi ndërmjet Republikës së Shqipërisë duke vepruar nëpërmjet Këshillit të Ministrave dhe Trans Adriatic Pipeline AG, në lidhje me Marrëveshjen e Qeverisë Pritëse të datës 5 prill 2013, nënshkruar më 8.6.2018.
70. Marrëveshje e përbashkët e prokurimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, Komisionit Evropian dhe vendeve anëtare të Bashkimit Evropian për të prokuruar kundërmasat mjekësore, nënshkruar nga RSH më 21.4.2020, ratifikuar me ligjin nr.60/2020.
71. Partneriteti Ndërkombëtar për Informim dhe Demokraci, Paris, aderuar më 11.11.2022.
72. Marrëveshje midis Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, Këshillit të Ministrave të Bosnjës dhe Hercegovinës, Qeverisë së Malit të Zi, Qeverisë së

Republikës së Serbisë dhe Qeverisë së Republikës së Sllovenisë, mbi procedurat e Vendit Pritës për statusin e organizatës së Task-Forcës Mjekësore të Ballkanit dhe personelit të saj, nënshkruar në Tiranë, më 6.5.2022, për palën shqiptare.

73. Marrëveshje ndërmjet palëve të Konventës së Bashkëpunimit Policor për Evropën Juglindore mbi shkëmbimin e automatizuar të të dhënave të ADN-së, të dhënave daktiloskopike dhe të dhënave të regjistrimit të automjeteve dhe Marrëveshjes së saj zbatuese, bërë në Vjenë, më 13.9.2018, ratifikuar me ligjin nr.13/2019, hyrë në fuqi më 11.8.2019 për palën shqiptare.
74. Protokoll i ndryshues i Marrëveshjes ndërmjet palëve të Konventës së Bashkëpunimit Policor për Evropën Juglindore mbi shkëmbimin e automatizuar të të dhënave të ADN-së, të dhënave daktiloskopike dhe të dhënave të regjistrimit të automjeteve, nënshkruar nga pala shqiptare në Tiranë, më 30.9.2021.
75. Protokoll i gjashtë shtesë i Marrëveshjes për krijimin e forcës shumëkombëshe paqeruajtëse të Evropës Juglindore (MPFSEE), nënshkruar më 12.6.2019.
76. Marrëveshje ndërmjet Këshillit Ministrave të Bosnjë dhe Hercegovinës dhe qeverive të shteteve palë në SEECF, për Marrëveshjen e Vendit Pritës për Sekretariatit e Këshillit të Bashkëpunimit Rajonal (RCC), nënshkruar në Plovdiv, më 14.9.2007.
77. Marrëveshje për programin e shkëmbimit të studimeve universitare në Evropën Qendrore (CEEPUS IV), bërë në Varshavë, më 20.9.2023, nënshkruar nga Shqipëria në Varshavë, më 20.9.2023.